

Elementet folklorike të Mitrush Kuteli dhe Nikolaj Gogoli si formë interteksti



Linguistics

Keywords: diskursi oral, proza, metonimi, alegori, letërsi e shkruar, interteksti, etj.

Rovena Vata

Centre for Albanological Studies, Tirana, Albania.

Arburim Iseni

State University of Tetova, Macedonia.

Abstract

Dhimitër Paskoja, që ne e njohim si Mitrush Kuteli, shkroi sipas Fjalës së Orakullit Oral shqiptar. Temat për të cilat shkroi i hulumtoi deri në thellësi të origjinave të tyre mitike, historike, narrative e semantike dhe i modelon sipas gjedhëve paraprake të njohura, të kulturës gojore, të këngëve, përrallës, fjalës së urtë, traditës etnike, gojëdhënës e magjisë. Në të vërtetë, diskursi oral në prozën e tij, shumë herë zhvillohet si diskurs i identitetit. Ky njeri, lidhet me letrat shqipe, përmes amëzave orale, si model shkrimi e mendimi, si gjuhë e si etnos kombëtar, por edhe si letërsi vendi, të cilën ky do ta rigjenërojë në mënyrë të vet, përmes një shkrimi letrar që nisat prej përshkrimit e ecën drejt metonimisë dhe alegorisë.²⁶ Pra, në prozën e Kutelit, elementet e gojshëmërisë janë të pranishme edhe në letërsinë e shkruar, si skenizëm, që domethënë se ndihen *gjestet*, *mimika*, *grimasa*, thënë ndryshe, teksti oral i jep tekstit të shkruar kutelian një efekt kinomatografik²⁷.

Vetë Kuteli pohon se *“bazën e vërtetë letrare ma dhanë përrallat e gjyshes e të fqinjit, folklori ynë i pasur, që nisa ta njoh që nga vogëlia. Përrallat e dëgjuara ose të lexuara ishin ato që më mbrijtën në moshë të njomë. Pastaj tregimet gojore të njerëzve tonë, sidomos të pleqëve, pranë zjarrit e në hije të drurëve, ngjarje të moçme, luftra, ngjarje të mërgimit”*²⁸. Kemi të bëjmë me një shkrimtar që formimi i tij është i qartë dhe prerë mbi bazë të krijimtarisë gojore. Kuteli e quan folklorin *si një ushqim shpirtëror*. Për nga vlerësimi shumë i madh dhe për nga shfrytëzimi shumë produktiv që i bëri folklorit Kuteli, ngjan me prozatorin e famshëm rus Nikolaj Gogolin i cili, që i vogël u njoh me këngët, përrallat, legjendat ukrainase të vendit të vet²⁹. Jo vetëm kaq, por ajo që është me e theksuar mes këtyrve autorëve janë disa veçori si: *fjala*, *gjestet*, *grimasa*, *mimika*, *interpertimi*, *deklamimi*, *përftesat tregimtare*, Kuteli tregimin e quan *“rrëfim”*, kurse Gogoli e quan *“skaz”*. Një tjetër pikë e përbashkët e Kutelit me Gogolin është edhe fakti se ata të dy sollen diçka të re në letërsi duke e demokratizuar atë. Ata filluan të afrohen me jetën e popullit e të pasqyrojnë psikikën e tij si dhe kontraditat shoqërore. Gogoli zgjodhi *humorin* dhe Kuteli *alegorinë* për të fishkulluar me vetëdije të këqijat e shoqërisë³⁰. Sipas Belinskit, fryma komike ose humori i Gogolit kanë një karakteristike të tyre të veçantë: *Ai është një humor i thjeshtë rus, i sinqertë, ku autori bën sikur është një lolo*³¹. Tregimet e Gogolit kanë një frymë popullore të shkallës më të lartë; po unë do të zgjatem për karakterin e tyre popullor, sepse karakteri popullor nuk është meritë, por një kusht i domosdoshëm për çdo vepër artistike, në qoftë se me karakter popullor kuptojmë vërtetësinë e pasqyrimin të zakoneve, shprehive dhe karakterit të këtij ose atij

²⁶ Kujtim Rrahmani, *“Oraliteti si intertekst”*, AIKD, Prishtinë, 2000, f. 136.

²⁷ Po aty f. 137.

²⁸ Sabri Hamiti, *“Letërsia moderne shqiptare”*, Albas, Tiranë, 2000, f. 123.

²⁹ Nexhip Gami, *“Histori e letërsisë së huaj shek 19”*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 359 - 361.

³⁰ Aurel Plasari, *“Midis të gjallëve dhe të vdekurve”*, Apolonia, Tiranë, 1995, f. 34.

³¹ V. G. Belinsk, *“Artikuj kritike”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1977, f. 42.

populli vendi. Jeta e çdo populli shfaqet në format e veta që janë karakteristike vetëm për të dhe, si rrjedhim, në qoftë se jeta përshkruhet me besnikëri, ajo është përshkruar dhe në frymë popullore. Kështu humori i Gogolit është një humor i qetë, i qetë në revoltimin e vet, i sinqertë në dredhite e veta. Por në krijimtarinë artistike ka edhe një lloj tjetër humor, një humor të hapet dhe kërcenues; ai të pickon gjersa të të dalë gjak, të përshkon trupin gjer në kocka, të pret me gjithë forcën, të fshikullon hidhur me kamxhik djadhtas e majtas, si të ishte gjarpër, një humor i hidhur, helmues, i pamëshirshëm. Arsyja e kësaj fryme komike, e këtij përshkrimi që të bën të qeshesh, qëndron jo në aftësinë ose në drejtimin e autorit për të gjetur gjithëkund anët qesharake, por në besnikërinë ndaj jetës³². Në qoftë se Gogoli tallet shpesh me heronjtë e vet, këtë e bën pa inat të madh, pa urrejtje; ai e kupton se ata janë pa vlerë, por nuk inatoset për këtë; bile duket sikur kënaqet me këtë, siç kënaqet një i rritur me lodrat e fëmijëve, të cilat për të janë qesharake me naivitetin e tyre, por me të cilat ai ka qejf të merret. Po prapëseprapë, ky është humor, sepse nuk i fal anët e ulta, nuk e fsheh dhe nuk e zbukuron karakterin e shëmtuar të tyre, sepse, duke na mahnitur me përshkrimet e këtyre anëve të ulëta na ngjall njëkohësisht neverinë ndaj tyre³³. Autori nuk i lejon vetës as një sentence, asnjë këshillë morali; ai s'bën tjetër veç i pikturon sendet ashtu siç janë. Karakteristika dalluese e tregimit të Gogolit janë thjeshtësia e subjektit, karakteri popullor, vërtetësia e plotë e jetës, ai nuk e zbukuron jetën, por edhe nuk shpif kundër saj; dhe nuk fsheh asgjë të shëmtuar të saj, jeta tek ai është një portret i vërtetë, në të cilat janë pikturuar me një ngjashmëri të çuditshme që nga shprehjet e origjinalitetit gjer në nishanet e fytyrës së tij, origjinaliteti të gjallërimi komik, i mundur gjithmonë nga ndjenja e thellë e trishtimit dhe e mërziës. Ai është i aftë të tërheqë vemendjen e lexuesit me hollësira të vogla e të parëndësishme. Tregimet e tij janë të tilla në fillim të bejnë të qeshesh e pastaj të trishtëj. Ashtu si Kuteli e pranon që folklori është burim kryesor për krijimet e tij edhe Gogoli shprehet: *“Kjo novelë është gojëdhënë popullore. Unë nuk kam dashur të ndryshoj asgjë dhe po e tregoj thuajse me atë thjeshtësi siç e kam dëgjuar”*³⁴, nga ana tjetër Kuteli shprehet: *“Rrëfimet e mia janë reflektimi i tregimeve të pleqve dhe jo reflektim i ndonjë letërsie të shkruar. Në fund të disa tregimeve kam vënë edhe emrin e atij që ma ka treguar. Përse? Për mirënjohje. Njeriu, pra edhe shkrimtari, duhet të jetë i ndershëm ndaj atij që e ka ndihmuar. Në një gjë të tillë kisha bërë edhe në përrallat e vëllimit Xinxifilua (kisha vënë emrin e tregonjësit), por redaksia e gjeti të udhës të heqë nga një vijë të zezë, të shlyejë emrat. Dhe me vjen keq”*³⁵.

Të tregimi *“Vjeshta e Xheladin beut”*, mallkimet e Maros së Kovit, të çmendurës së dikurshme prej Xheladin beut, që ajo i bën atij pse deshi ta çnderonte, pa e njohur edhe vajzën e tij, rrjedhin të shumta dhe me vrull dhe janë tipike si në rrëfimet popullore:

“Y - y - y, murtajë. Pusht Stambolli. Matuf! (...) Të marrtë zoti mendtë! Më ke lenë turp të zi më të lëntë perëndia pa sy, të heqshin për peri! Më ke ngrënë jetën, të hëngërt mortja! (...) Të çaftë ulku e të nxjerrtë zorrët! Të pjekshin në hell të gjallë! Humbsh e mos u duksh, mos u dëgjofash. (...) Na plase, më të plastë dhjamët e syrit! Na kalle frikën, më të kallçin të gjallë në

³² Po aty, f. 52.

³³ Po aty, f. 50-51.

³⁴ Nikolaj Gogoli, tregimi: *“Kukudhi”*, në *“Tregime dhe novela”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1987, f. 190.

³⁵ Aurel Plasari, *“Midis të gjallëve dhe të vdekurve”*, Apolonia, 1995, f. 38.

*varr! Na dogje të djegshin lugat (...) Ike mos u kthefsh; ike, të ikshin mendtë e kokës! Mos arrifsh i gjallë në shtëpi!*³⁶.

I tërë ky lum mallkimesh ka një domethënie të përcaktuar. Ato janë shfaqjeje e një dhimbjeje të madhe dhe e karakterizojnë, shumë saktë fytyrën e vërtetë të Xheladin beut. Ato janë edhe dëshmi të një historie sociale, psikologjike e shpirtërore të një gruaje, por edhe të një grupi shoqëror që ka provuar thundrën e beut, i cili çdo gjë e konsideronte si pronën e tij.

*“Pashai e dëgjoj dhe, fundi, i tha: Mirë, e mora vesh. Ti shko, çupën lere këtu, se është malli im, nga çifligu im.....të gjitha shkuan kot; pashai nuk u tund nga fjala e parë. Është malli im, do ta martoj vetë”*³⁷.

Vetë thellësia e motivimit të tyre, krijon një kyçje intertekstuale, që çon kah krijimi i një strukture tematike, në fund të së cilës Xheladin beu duhet ti lajë të gjitha në një dërrasë mu ashtu si e nami gruaja e dhunuar të *ikshin mendtë e kokës*, ai edhe përfundon. Të shumtën e herës, rrëfimi dhe ideja në prozën e Kutelit, vazhdimisht ndodhen të sfocuar nga formulat, përkatësisht edhe nga format e shkurtëra të krijimtarisë gojore, siç janë fjalët e urta, mallkimet, urimet. E njëjta dukuri ndodh edhe të tregimet e Gogolit të cilat janë të pasura me mallkime, fjalë të urta dhe urime.

*“Si, si? Ti, moj bushtër, - i tha e shoqja e dhjakut duke iu gërmushës endeses, - ti, moj shtrigane, ti ia prishke atij mendjen me magjira dhe e bëke të të vijë në shtëpi? M’u hiq qafe, o e mallkuar!-tha endësja duke u zbrapsur. - Ah, moj shtrigane e mallkuar, mos e mbiftë fara, moj horre, ptu!...- E shoqja e dhjakut e pështyu endesen në fytyrë. Ah, zuzkë!-thirri kryeplaku, duke fshirë fytyrën me kindin e petkut dhe duke ngritur kamxhikun. Kjo lëvizje i detyroj gratë të shpërndareshin duke sharë e duke mallkuar. - Çfarë poshtërsie! - përsëriti ai duke vazhduar të fshihej”*³⁸.

Po të njëjta mallkime dhe fyrye shohim edhe në këtë sekuensë. Ato janë tipike për bashkëbisedime orale dhe jo dialogje të shkruar.

*“Maskara i ndyrë! Shko e laj fytyrën! Zuzar i poshtër! S’e kam parë ndonjëherë tët ëmë, por unë e di që është qelbanike! Edhe yt atë qelbanik është”*³⁹.

Jo të pakta janë edhe fjalët e urta të përdorura nga Gogoli si: *“Mos kërko para, po kërko njerëz të mirë më të cilët të bisedosh”*, - ka thënë një njeri i urtë! *“Mirë thotë fjala e urtë se në kufomën e të vdekurit mund të mbështetësh vetëm gardhin”*. *“Një fjalë me vend është si një fjalë e shkruar: nuk e pret as sëpata”*. E ka mirë ajo fjala e urtë që thotë: *“Për të takuar një mik s’janë kurrigjë shtatë vjorsta udhë!”*. *“Mirë që takuam një të vdekur rrugës; thonë se është ugur.”* Qenka tamam ashtu siç thotë fjala e urtë: *“As nga nëna, as nga babai, po nga trimi rrugëtar!”*. *“Mos gënje, ndero më të mëdhenjtë dhe ruaj virtytin në zemër”*. Në të njëjtën linjë qendron dhe Kuteli

³⁶ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Vjeshta e Xheladin beut”* në *“Tregimi të zgjedhura”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1972, f. 174.

³⁷ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Vjeshta e Xheladin beut”* në *“Tregime të zgjedhura”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1972 f. 156.

³⁸ Nikolaj Gogoli, tregimi: *“Nata para Kërshëndellave”* në *“Tregime dhe novela”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1987, f. 96.

³⁹ Po aty, f. 21.

ku veprat e tij janë të pasura me fjalë të urta si: “*Beu edhe gomar të bëhet, mos i hyp*”⁴⁰, “*Gjithë derrat një turi kanë*”⁴¹.

Të tregimi “*Natë prilli*” ndihet qartë toni, rrëfimitar i *netëve* të tjera të Kutelit. Fjala e urtë: *në gaze prit të të ftojnë, në helme ngrehu e shko vetë*.⁴² Kjo fjalë intensifikon semantikisht tekstin dhe e verifikon vërtetësinë e tij, në raportet e zhvilluara brenda marrëdhënieve të personazheve. Ndërsa, është fare tjetër funksioni i mallkimeve të tregimi “*Vendosa të shkoj në mëgrim*”, ku gjejmë mallkime si:

“*Ju beftë nëna lopë e kuqe a baliskë kush do të hyj i fundit në ujë! - Ua marrtë zhaba qumështin e dhive e mbeçin pa dhallë! - Ju mbylltë dera me tre kyçe e tre katarë!*”⁴³.

Këtu, mallkimet janë vetëm realitet imitimi. Mallkimet janë të shpeshta dhe karakteristike dhe për stilin e Gogolit si:

“*Mortja të hëngërt, o burlak i poshtër! Të vraftë yt atë me poç në kokë! Të shkaftë këmba në akull dhe thefsh qafën, zuyar i mallkuar! Të djegtë e të përvëloftë djalli mjekrën në atë botë!*”⁴⁴.

Tregimi “*Panairi i Soroçinit*” dhe tregimi “*Kryengritje për lugat*” është ngritur mbi një truall të veçantë idesh dhe projeksionesh sociale, në rrënjë të cilave janë besetytnitë dhe besimet religjioze pagane e mbaspagane në lugetërit dhe misionet e tyre shkatërrimtare. Bestytinia si një nga format e vjetra të projektimit të botës dhe të të vërtetave jetësore, këtu është intertekstualizuar dhe fuqizuar në përmasën e një realiteti ‘të verifikueshëm’:

“*Që kur i doli të birit të Qipros fjala se nuk beson lugat, humbi nderë e dashurinë e fshatit, si në turq e në kaurë. Jo vetëm se s’ka njeri që ia kthen mirmëngjesin, jo vetëm se i thonë mason e papistan, po ia paskan ngjitur se nga pun’e tij - që s’beson lugat! - perëndia i punon fshatit kaq alamete e valoma. Bie shi shumë e vjen Lumi i Madh: fajin e ka çuni i Qipros! Nuk bie shi e thahet misri: fajin e ka çun’ i Qipros! U bie gëlbaza dhenvë: fajin gjithë çuni i Qipros! E gjithë çuni i Qipros e ka fajin se u bie hiri vreshtave, se ikën peshku nga kufiret tona e se i hyri krimbi arrës së Banushit. E jo vetëm kaq, po i paska dalë fjala se valla ha bukë me të madhë e shejtan*”⁴⁵.

Siç mund të shihet nga fillimi i rrëfimit, i tërë tregimi ngrihet mbi një realitet etnologjik. Vetë ky realitet paraqet intertekstin bazë mbi të cilin ndërtohet tragjika e personazhit që quhet Çuni i Qipros, i cili i vë në dyshim principet e këtij realiteti besetytnor. Si struktura narrative, ashtu edhe vetë intriga e vetë tregimit është e lidhur me mosbesimin e Çunit të Qipros në lugat, që për fshatin, për realitetin mendor e shpirtëror të tij, paraqet një herezi të padëgjuar, për të cilin zoti ndëshkon njerëzit, gjënë e gjallë të tyre, pemët dhe të lashtat.

⁴⁰ Mitrush Kuteli, tregimi: “*Vjeshta e Xheladin beut*” në “*Tregime të zgjedhura*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1972 f. 150.

⁴¹ Po aty, f. 140.

⁴² Mitrush Kuteli, tregimi: “*Natë Prilli*” në “*Netë Shqiptare*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 6.

⁴³ Mitrush Kuteli, tregimi: “*Vendosa të shkoj në mëgrim*”, në “*Netë Shqiptare*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 260.

⁴⁴ Nikolaj Gogoli, tregimi: “*Panairi i Soroçinit*” në “*Tregime dhe novela*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1987, f. 21.

⁴⁵ Mitrush Kuteli, tregimi: “*Kryengritje për lugat*” në “*Netë Shqiptare*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 199.

Brenda kësaj intrige, ka ndodhur një dramë, me vetë shfaqjen mosbesimit të të birit të Qipros. Konflikti i këtushëm dramatik, rrjedh edhe si konflikt diskursiv e moral, po edhe si konfrontim ideologjik. Shenjat e mitosit, si një diskurs oral etnologjik i këtushëm, janë ndeshur fuqishëm me shenjat e një projekti vetiak të botës e jetës, që paraqet një diskurs personal, metafizik, të personazhit. Ndeshja e këtyre diskurseve është e fuqishme sikurse që është edhe loja e tyre e rrjedhshme si gjuhë. Si forma të shkurtëra apo si formula, mallkimet kanë një denduri përdorimi dhe një funksion të veçantë, shumë më tepër se ornamental, në prozën e Kutelit. Ato, sikur edhe realiteti në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Rituali i mësipërm vazhdon edhe më, në trajtë retrospeksioni fëmijëror, por tash me rikujtimin e imazheve të festës së Shëngjergjit, të përshkrimit të prirjes së tij; me përgatitjet, të shtënat, stolisjet, lajmet, këngët e vallet, me veçantësimin e festës si evgjite. Natyrisht, imazhe të tilla, në nivelin e diskurseve kulturore, paraqesin një vlerë interdiskursive dhe intertekstuale përbrenda tekstit. Rituale vetëm sa e kompletojnë si interdiskursivitetet botën retrospektive të personazhit. Në këtë funksion mund të merret edhe formulat popullore, etnologjike, ta zëmë, *për pizga e bilbilë*:⁴⁶

*“Pizga dalte, Bilbili mos dalte (për pizga) dhe Bilbili mos dalte, Pisga dalte (për bilbil)”*⁴⁷.

Ato janë më shumë, se lojë fëmijësh dhe më shumë se diskurs oral nisur nga përmasa, se janë të dhëna jetësore. Ashtu siç e shohim të Kuteli përshkrimin e festës së Shëngjergjit edhe Gogoli trajton festën me universale në botë, Vitin e Ri.

*Kukurisjet e turmës ia shpërblenin mundinin atij gaztori. Hapeshin dritaret e vogla dhe dora thatime e ndonjë plake, - se vetëm pleq e plaka kishin mbetur nëpër shtëpura, - zgjatej poshtë me një copë suxhuk a me një ngastër byrek. Djemtë e vajzat hapnin kush e kush më parë thesin dhe rrëmbenin prenë. Diku djelmoshat mblihdeshin nga të gjitha anët dhe rrethonin një turmë vajzash: shpërthenin zhurmat e britmat, njeri hidhte një shuk dëbore, një tjetër rrëmbente një thes me gjithfarë sendesh”*⁴⁸.

Në të vërtetë shenjat e tilla të një diskursi oral që hapet ndaj lojës interdiskursive dhe intertekstuale në tekst, reflektojnë një raport të tërë të shkrimtarit ndaj botës orale. Për Kutelin, Oraliteti si tekst dhe si etnologji, pra edhe si ritual, nuk është vetëm dije e pasion, por edhe experience. Madje, në prozën e tij, dimensionin e Oralitetit si experience, shpesh herë del në plan të parë. Arsyet e kësaj duhen kërkuar në përjetimin e pasionuar të Kutelit ndaj kësaj tradite e krijimtarie. Një pasion që në çaste të caktuara atij edhe mund t'i jetë hakmarrë, ngase krijimi i tij nuk ngirhet si intence artistike autoriale mbi krijimin paraprak gojor dhe mbi lëndën e gjallë nga jeta e etnosit. Një shembull ky tipik ku pasionet për dëshmi experience e dëmton imagjinaturen si intercionalitet estetik. Të tregimi *“Natë vjeshte të tretë”* rituali magjik jepet kryesisht si prezantim i personazhit. E tillë është kjo sekuence:

⁴⁶ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Natë vjeshte të tretë Mitrush Kuteli, në “Tregime të zgjedhura”, Naim Frashëri, Tiranë, 1972, f. 92.*

⁴⁷ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Fije nga jeta e Theofil Kostorit” në “Netë Shqiptare”, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 91 - 92.*

⁴⁸ Nikolaj Gogoli, tregimi: *“Nata para Kërshëndellave”, në “Tregime dhe novela”, Naim Frashëri, Tiranë, 1987, f. 73.*

Një narracion i tillë në raport me *gjyshen* dhe ritualet e saj, është dhe me shumë se aq, është element i fortë i ambientimit të personazheve të Kutelit dhe i enterierit hapësinor e ideor të rrëfimit të tij.

Ndërsa të tregimi tjetër *“Rusa-Papusa”*, rituali i shoqëruar me këngë motmoti prezanton vetëdije reale, branda botës së rrëfimit përkatës. Aty, fëmijët janë ata që sjellin shiun dhe të mirat e tjera, përmes lutjeve të tyre; porse ata duhet të shpërblehen për punën e tyre:

“Ora-ona, Tri perona, Bjerë shi, Në arat tona”

“Kur binte mot i thatë e digjeshin misrat në fushë sa as prifti, as hoxha e as të dy bashkë s’i mblidhnin retë dot na thosh neve bota: - Haj, o çuna, me ndonjë rusicë, që të bjerë shi! Ne s’e bënim fjalën dy, se lugën e kishim në brez edhe haj! si në maj derë më derë. E të shikoje atëherë, o i mirë, si errej Krusha pas gjurmës sonë, si gjëmonte e si ia kriste një shi i trashë sa një litar, që gëzonte turq e kaurë”⁴⁹.

Tregimi *“Lugetërit e fshatit tonë”* paraqet një seri rrëfimesh të lidhura në një temë, me një tip personazhi dhe me një tip situatash të ngjashme, që të gjitha të lidhura me lugat. E tërë baza e rrëfimit dhe e situatave është popullore, dhe në të vërtetë, interteksti oral në këtë rast përbën vetë tekstin.

“Vjet kemi pasur lugat të fortë Shaqon e Shabanit, njëviti një tjetër që u bë edhe kanxhalloz edhe sivjet Meron e Cutes. Ky murgu Mero ra e vdiq aty e dy muaj nga njëfarë ograie, se i pat qenë shkruar. Që në të gjallë fshati thosh se do ngrihet lugat. E me të vërtetë, sapo vdiq, ra e u ngrit.”⁵⁰.

Ky projektion i rrjedhës së kohës, ka të ngjarë që është një intertekst - koment autorial, i ndërkallur në gojën e personazhit i cili flet dhe vepron si aktant i një strukture të tërë narrative, kompozicionale e semantike orale. Mbi ndërtime të tilla miniaturale, qoftë në këtë bosht tematik, qoftë në boshte të tjera, mund të hasim edhe në ndonjë pjesë tjetër të tregimit. Me një fjalë, Kuteli në mes rreshtave shpërthen si ide, ndërsa në rrafshin e sintagmes si gjuhë; forma këto të ndryshme të ndajvëna mbi gjedhën narrative e tematike orale.

Krijimtaria popullore i ka përfytyruar kurdoherë qeniet mbinjërzore si pjesëmarrse në jetën e përditshme të njeriut, që bashkëveprojnë me njeriun, e ndihmojnë ose e pengojnë atë. Kështu vepron edhe Gogoli me figurat e dajve, shtrigave etj.

“Vajzë për kokë të vajzës! - vijoi djali me kaftan të bardhë, pa ia hequr sytë.- Unë do të falja tërë ç’kam e ç’nuk kam për ta puthur një herë. Por, ç’e do! Paska edhe një djallushë atje përpara”⁵¹.

Peisazhi luan një rol me rëndësi duke afirmuar konceptin lirik të autorit, atmosferën emocionale të veprimit si të Kuteli ashtu edhe të Gogoli.

⁴⁹ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Rusa-Papusa”*, në *“Netë Shqiptare”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 177-179.

⁵⁰ Mitrush Kuteli, tregimi: *“Lugetërit e fshatit tonë”* në *“Netë Shqiptare”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 295.

⁵¹ Nikolaj Gogoli, tregimi: *“Panairi Soroçinit”* në *“Tregime dhe novela”*, Naim Frashëri, Tiranë, 1987, f. 21.